



Prill 2020

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nëntor

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Prill 2020

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2020
Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: amanda.kojku@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Prill 2020 arriti në 109.7 për qind;*
- *Norma vjetore e inflacionit për muajin Prill 2020 ishte 1.9 për qind;*
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Prill 2020 ishte 115.43 lekë për dollarë dhe 125.4 lekë për euro;*
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Prill 2020 shënuan kuotën 0.45 për qind për ato 12-mujore; 0.48 për qind për depozitat 6-mujore; 0.16 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.32 për qind për depozitat 1-mujore;*
- *Normat e interesit për huatë në lekë ishin 6.06 për qind për huatë 12-mujore dhe 5.91 për qind për ato 6-mujore;*
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.345.011 milionë lekë në muajin Prill, duke shënuar një rritje prej rreth 5.8 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;*
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të 2020-ës rezultoi me rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 51 milionë euro.*
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar - Prill 2020 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 15.6 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej 22.7 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Prill 2020, arritën në rreth 133.224 miliardë lekë ose afërsisht 96% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 148.804 miliardë lekë ose rreth 92% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*


Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Prill 2020 ishte +1.9%. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +1.4%. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Prill 2020 pësoi rënie prej 0.4 përqind krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa në dy muajt paraardhës, përkatësisht Mars dhe Shkurt, indeksi shënoi rritje prej 0.6 dhe 0.4 përqind, krahasuar me muajin përkatës. Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Prill 2019 pësoi rënie prej 0.2 përqind në krahasim me muajin paraardhës.

Krahasuar me muajin Prill 2019, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 4.3%, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 3.8%, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 1.9%, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1.3% etj.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 3.1%, pasuar nga “Veshje dhe këpucë” dhe “Shëndeti” me 0.7% përkatësisht etj.



Ndryshimi mujor i indeksit është -0.4%. Krahasuar me muajin Mars 2020, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 1.7%, pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1.0%, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0.2%, “Veshje dhe këpucë” me 0.1% etj.

Nga ana tjetër çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” u rritën me 1.1%, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 0.8% dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0.1%.

Tab - 1 **Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)**

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2019	1.9	1.7	1.1	1.4	1.5	1.3	1.5	1.5	1.3	1.3	1.4	1.2
2020	1.5	1.2	2.1	1.9								


Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Prill 2020, arriti në 125.4 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.88 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Prill, një euro u këmbye me 123.49 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Prill 2020 arriti në 115.43 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 2.99 përqind kundrejt muajit Mars 2020. Në fund të muajit Prill, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 113.55 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Prill të vitit të kaluar, pas një peridhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një dobësim të lehtë ndaj monedhës evropiane në masën 0.86 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 4.39 përqind. Në pëgjithësi, forcimi i lekut në vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të riskut për ekonominë tonë.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një rritje mesatare rreth 0.92 dollarë/euro.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave



Gjatë muajit Prill 2020, normat e interesit të depozitave me afat 6 dhe 12 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.48 dhe 0.45 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 1 dhe 3 mujore që arritën kuotën 0.16 dhe 0.32 përqind përkatësisht.

Normat e interesit të depozitave 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.13, dhe 0.01 pikë përqindje respektivisht, ndërsa normat e interesit të depozitave 1 dhe 3 mujore kanë pësuar rënie mujore me 0.38 dhe 0.01 pikë përqindje respektivisht.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të të gjitha depozitave me afat maturimi 1, 3, 6 dhe 12 mujore kanë pësuar rënie vjetore prej përkatësisht 0.30, 0.02, 0.04 dhe 0.03 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore gjatë muajit Prill 2020 arritën përkatësisht kuotën prej 5.91 dhe 6.06 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë pësuar rënie mujore prej 0.84 dhe 0.50 pikë përqindje respektivisht. Gjithashtu, krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore pësuan rënie vjetore prej 0.96 dhe 0.17 pikë përqindje respektivisht.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Prill 2020 arritën nivelin 2.05 përqind duke shënuar kështu rritje mujore prej 0.07 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 0.94 pikë përqindje.



4. Bilanci i Pagesave


Bilanci i përgjithshem i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2020 rezultoi negativ në rënie të mjeteve të rezervës, prej rreth 51 milionë euro. Tremujori i parë i 2020-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 226 milionë euro ngushtuar në terma vjetorë me rreth 9%. Përmirësimi i deficitit korrent, në masën më të madhe është nxitur nga ngushtimi i deficitit tregtar në mallra (6%). Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 201 milionë euro, në rënie me 29 milionë euro referuar nivelit në një vit më parë. Flukset hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) shënojnë 236 milionë euro dhe mundësojnë plotësisht mbulimin e deficitit korrent.

Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Gjatë tremujorit të parë 2020, vëllimi i transaksioneve korrente shënon 2,534 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 3%. Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në 226 milionë euro, rreth 9% më i ulët krahasuar me një vit më parë. Ecuria e deficitit korrent ka reflektuar zgjerimin e balancave pozitive në shërbime dhe të ardhura dytësore. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për tremujorin e parë të 2020 (Fig-6):

- (i) bilanci tregtar me -653 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 272 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -49.2 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 204 milionë euro.


Fig-5



Bilanci i Pagesave per T1 - 2020

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-6



Llogaria Korente per T1 - 2020

Burimi: Banka e Shqipërisë



5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Prill 2020, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 46.978 milionë lekë krahasuar me muajin Prill të vitit 2019. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankës qendrore me 38.924 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë pësuar rënie me 18.255 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 25.339 milionë lekë e bankës paradepozituese.


Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.345.011 milionë lekë në muajin Prill 2020, duke shënuar rritje prej rreth 73.279 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 5.8 përqind.

Ndërsa në muajin Prill 2020, sistemi bankar rezulton me rënie mujore prej 20.554 milionë lekë ose -1.5 përqind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.




6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Prill 2020 arriti në rreth 578.248 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 32.473 milionë lekë, ose rritje me rreth 5.95 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (51.4%) dhe monedhave të huaja (48.6%).



Gjatë muajit Prill 2020, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredisë, me rreth 60 përqind ose 346.928 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.44 përqind ose 199.142 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.16 dhe 2.31 përqind apo 18.296 dhe 13.365 milionë lekë.




Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Prill 2020, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredisë, me rreth 71.96 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.19 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.03 përqind dhe rreth 1.81 përqind.

7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 303.148 milionë lekë në fund të muajit Prill 2020. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Prill 2020 ka shënuar rritje mujore prej 1.03 përqind dhe rritje vjetore prej 1.06 përqind, duke arritur nivelin 22.5 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rritje mujore prej 1.69 përqind, dhe rritje vjetore prej 1.74 përqind, duke shënuar nivelin 29.1 përqind.

Fig-11



Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Prill 2020, kanë shënuar rritje vjetore prej 19.911 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 81.5 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Prill 2020 shënuan rritje prej 23.365 milionë lekë në krahasim me muajin Prill 2019. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 82.2 përqind të tyre.

Fig-12



Raporti i Depozitave ndaj M3



Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Prill 2020, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 82.2 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 12.6 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.3 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 81.5 përqind dhe rreth 15.8 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 81.8 përqind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 852.500 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (149.022 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (18.425 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (20.222 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.692 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Prill 2020, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.041.862 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 29.985 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 43.277 milionë lekë.




Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar - Prill 2020 janë mbledhur rreth 133.224 miliardë lekë të ardhura, përkundëjt shpenzimeve të përgjithshme prej 148.804 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 132.167 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 16.637 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 36% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 85.512 miliardë lekë (ose rreth 95% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 5.682 miliardë lekë (ose rreth 82% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 32.196 miliardë lekë (ose rreth 100% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jokatimore në nivelin 8.143 miliardë lekë (ose rreth 105% e planit për periudhën Janar - Prill 2020).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 132.167 miliardë lekë, 24.959 miliardë lekë (19% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 11.485 miliardë



lekë (9%) për shpenzime interesi, 13.113 miliardë leke (10%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 288 miliardë lekë (0.2%) për subvencione, 53.515 miliardë lekë (40%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 13.573 miliardë lekë (10%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 14.450 miliardë lekë (11%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 30% (shpenzime personeli), 28% (shpenzime për interesat), 26% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 22% (subvencione), 29% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 24% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 59% (shpenzimet e tjera) përkundëjt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 21%, ndërsa financimi i huaj është 20% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Prill 2020 ishin rreth 133.224 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 123.391 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 8.143 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Prill 2020 (mld Lekë) Revenues during April 2020 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Prill '20 April '20	Prill '19 April '19	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	7.37	11.13	-33.7
	Taksa doganore (Custom Tax)	0.37	0.55	-32.7
	Akcizat (Excise)	2.39	3.36	-28.9
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	1.76	3.62	-51.2
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	2.58	3.28	-21.2
	Taksat nacionale (National Tax)	1.72	2.82	-39.0

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Prill - 2020

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: April - 2020

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej -15.6 miliardë lekë gjatë periudhës Janar - Prill 2020, u financua kryesisht nga huamarrja e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe nga huaja afatgjatë e huaj.

Për muajin Prill 2020, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 29.064 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 41.856 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Prill 2020, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 26.4 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë muaj, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 36.6 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 5.1 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2016	2017	2018	2019	2020	2016	2017	2018	2019	2020	2016	2017	2018	2019	2020	
Janar	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.5	2.8	1.7	1.9	1.5	January
Shkurt	1.1	0.5	0.8	0.6	0.4	1.0	1.0	1.1	1.1	1.1	0.2	2.2	2.1	1.7	1.2	February
Mars	0.5	0.4	0.3	-0.3	0.6	0.8	0.8	0.9	0.6	0.9	0.3	2.1	2.0	1.1	2.1	March
Prill	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	-0.4	0.5	0.5	0.5	0.4	0.6	0.3	1.9	2.1	1.4	1.9	April
Maj	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0		0.2	0.1	0.2	0.1		0.7	2.0	2.1	1.5		May
Qershor	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3		0.04	0.0	0.1	0.1		1.2	2.2	2.4	1.3		June
Korrik	0.0	-0.1	-0.3	-0.1		0.04	0.0	0.1	0.0		1.9	2.0	2.3	1.5		July
Gusht	0.9	0.4	0.4	0.3		0.14	0.1	0.1	0.1		2.0	1.6	2.2	1.5		August
Shtator	0.4	0.4	0.2	0.1		0.17	0.1	0.1	0.1		1.8	1.6	2.1	1.3		September
Tetor	-0.2	0.0	-0.2	-0.2		0.13	0.1	0.1	0.0		1.5	1.9	1.9	1.3		October
Nëntor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2		0.12	0.1	0.1	0.0		1.9	1.7	1.8	1.4		November
Dhjetor	0.9	1.0	1.1	0.8		0.19	0.2	0.2	0.1		2.2	1.8	1.8	1.2		December

Burimi: INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2016	2017	2018	2019	2020				Currency
					Janar	Shkurt	Mars	Prill	
					January	February	March	April	
<i>Mesatarja e periudhës</i>									<i>Average of period</i>
USD	128.29	112.56	108.43	109.94	110.06	111.94	112.08	115.43	USD
EURO	135.27	133.25	123.45	122.17	122.08	122.13	124.31	125.40	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>									<i>In the end of period</i>
USD	128.17	111.10	107.82	108.64	110.71	111.38	118.75	113.55	USD
EURO	135.23	132.95	123.42	121.77	122.13	122.74	130.66	123.49	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3 **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**
Annual Interest Rates (in ALL)

	2016	2017	2018	2019	2020				
Në përqindje					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	In percent
Norma e depozitave									Deposits rates
12-M	0.78	0.80	0.75	0.43	0.40	0.42	0.44	0.45	12-M
6-M	0.78	0.56	0.56	0.41	0.48	0.27	0.35	0.48	6-M
3-M	0.27	0.29	0.30	0.17	0.40	0.14	0.17	0.16	3-M
1-M	0.87	0.82	0.62	0.72	0.81	0.76	0.70	0.32	1-M
Norma e huasë									Lending rates
12-M	4.54	6.79	6.34	6.82	6.73	6.26	6.56	6.06	12-M
6-M	7.01	8.12	8.16	6.34	6.87	6.78	6.75	5.91	6-M
Norma e letrave me vlerë									Securities rates
Bono thesari 1/									Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	-	-	1.29	-	1.30	3-M
6-M	2.00	-	-	-	1.50	-	-	-	6-M
12-M	2.92	2.63	1.43	1.69	1.77	1.87	1.98	2.05	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Nr.	EMËRTIMI	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	36,012	71,182	104,160	133,224	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	204	785	1,118	1,690	Grants
II.	Të ardhura tatimore	34,315	66,979	97,001	123,391	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	23,535	46,931	69,240	85,512	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	11,493	22,929	31,850	39,229	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	2,255	4,506	9,086	10,852	Profit Tax
3	Akcizat	3,399	6,750	10,215	12,609	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,459	6,109	8,457	11,045	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	2,478	5,682	8,272	10,046	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	451	955	1,359	1,733	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,229	2,943	4,035	5,682	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	265	576	763	1,106	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	7	16	237	288	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	957	2,352	3,035	4,288	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	9,551	17,105	23,727	32,197	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	8,205	14,780	20,538	27,797	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,339	2,324	3,187	4,400	Health insurance
III.	Të ardhura Jotatimore	1,492	3,418	6,041	8,143	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë		0	1,398	1,398	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	986	2,223	3,170	5,072	Income of budgetary institutions
	TOTALI I SHPENZIMEVE	32,517	67,507	106,948	148,804	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	31,951	64,876	95,490	132,167	Current Expenditures
I.1	Personeli	6,184	12,428	18,700	24,959	Personnel expenditures
1	Paga	5,301	10,650	16,028	21,399	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	877	1,753	2,631	3,507	Social insurance contributions
I.2	Interesat	4,289	6,487	9,004	11,485	Interest
1	Të Brendshme	3,123	4,766	6,598	8,275	Domestic
2	Të Huaja	1,165	1,721	2,406	3,210	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,431	6,063	9,389	13,113	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	64	126	183	288	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	13,486	27,854	40,287	54,299	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	10,290	20,441	29,980	40,069	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,715	6,712	9,606	13,446	Health insurance
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,499	6,841	10,674	13,573	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	2,995	5,077	7,252	14,450	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	43	87	135	4,769	Unemployment insurance benefits
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca		0		0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	567	2,632	11,458	16,637	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	-1	646	8,038	10,440	Domestically financing
2	Financimi Huaj	568	1,901	3,255	5,980	Foreign financed
IV	Detyrimet e prapambetuara					Arrears
V.	DEFICITI	3,495	3,675	-2,788	-15,580	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-3,495	-3,675	2,788	15,580	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-2,416	-1,680	5,859	730	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	2	29	58	69	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	5,408	8,635	10,735	27,939	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-7,826	-10,344	-4,934	-27,278	Others
V.3	I huaj	-1,078	-1,995	-3,071	14,850	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	364	1,565	3,507	4,517	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nënhua	184	364	767	910	Subsidiary Loan
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	6	-441	-1,257	-111	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,448	-3,119	-5,320	-11,718	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore		0		22,162	Budgetary Support

Tab - 5

Tabela e investimeve 2020

Table of investments 2020

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Financim i brendshëm	- 2,416	- 1,680	5,859	730	Domestic financing
<i>Në %</i>	69.1	45.72	210.2	4.69	<i>In %</i>
Financim i huaj	- 1,078	- 1,995	- 3,071	14,850	Foreign financing
<i>Në %</i>	30.9	54.28	-110.2	95.31	<i>In %</i>
Totali	-3,495	-3,675	2,788	15,580	Total
<i>Në %</i>	100	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2020
CUSTOMS REVENUES 2020**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Taksë doganore	451	955	1,359	1,733	Customs Duties
TVSH	7,434	15,763	22,596	28,718	V.A.T
Akcizë	3,399	6,750	10,215	12,609	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	246	465	661	710	Others (Mineral Rent)
TOTALI	11,530	23,933	34,832	43,771	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2020 (TAX REVENUE)

TVSH	4,059	7,166	9,254	10,510	V.A.T
Tatim mbi fitimin	2,255	4,506	9,086	10,852	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,459	6,109	8,457	11,045	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	2,232	5,217	7,611	9,336	National taxes
TOTALI	12,006	22,997	34,408	41,743	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	23,535	46,931	69,240	85,513	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2020

The Deficit and Its Financing for 2020

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
TË ARDHURAT	36,012	71,182	104,160	133,224	REVENUE
SHPENZIMET	32,517	67,507	106,948	148,804	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	3,495	3,675	-2,788	-15,580	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-3,495	-3,675	2,788	15,580	FINANCING
Financimi i brendshëm	-2,416	-1,680	5,859	730	Domestic
a. Bono Thesari Neto	1,501	3,103	3,750	6,434	Treasury bills
b. Obligacione	3,921	5,559	7,027	21,564	Bonds
c. Ndryshimi i gjëndjes së arkës	5,162	5,025	9,388	-13,745	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	5,485	6,866	12,579	-9,667	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	-323	-1,841	-3,191	-4,078	Deposit of Social & Health Ins.
d.Mjete në ruajtje	-49	-114	27	89	Non-budget revenues
e.Të ardhura nga privatizimi	2	29	58	69	Privatization receipts
f.Të tjera detyrime	-12,939	-15,255	-14,350	-13,621	Others
g.Huamarrje Brendshme Vendori	-15	-27	-41	-59	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	-1,078	-1,995	-3,071	14,850	Foreing
a. Hua afatgjatë	364	1,565	3,507	4,517	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	6	-441	-1,257	-111	Chang. of stat. Account
c.Ripagesat	-1,448	-3,119	-5,320	-11,718	Repayments
d.Mbeshetje Buxhetore	0	0	0	22,162	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 8

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	3M_I_2020	
Llogaria korente	-811.60	-865.60	-862.90	-1,041.20	-226.00	Current Account.
Bilanci tregtar	-2,602.80	-2,824.10	-2,871.00	-3,143.60	-653.30	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	713.70	797.10	986.10	906.60	199.70	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,316.50	-3,621.20	-3,857.10	-4,050.20	-853.00	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	796.60	1,081.90	1,104.00	1,274.00	272.40	Services Balance.
Shërbimet Kredi	2,395.70	2,856.20	3,065.80	3,398.20	649.40	Services Credit
Shërbimet Debi	1,599.10	1,774.30	1,961.80	2,124.20	377.00	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	174.10	28.90	-8.60	-139.70	-49.10	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	408.70	407.70	398.00	419.80	72.70	Income Credit
Të ardhurat Debi	-234.60	-378.80	-406.60	-559.50	-121.80	Income Debt
Bilanci i transfertave	820.50	847.70	912.70	968.10	204.00	Balance of Transfers
Transferta private	961.20	961.80	1,002.90	1,073.50	232.00	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	-140.70	-114.10	-90.20	-105.40	-28.00	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	66.20	122.30	104.00	76.10	24.80	Capital Account
Llogaria financiare	-664.30	-1,115.30	-1,145.40	-819.80	-211.10	Financial Account
Investime direkte	-936.50	-993.80	-1,026.00	-1,031.20	-214.20	Direct Investment
Investime portofoli	225.20	-100.00	-75.10	140.60	20.10	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	187.40	49.00	-50.40	53.00	-21.90	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	128.90	-186.30	-18.20	67.70	-60.90	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	47.80	185.70	368.30	-77.60	-51.00	Overall Balance
Rezervat	47.70	185.40	371.50	-77.70	-51.10	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	140.40	70.50	-6.10	-17.80	-4.90	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 9 MJETET VALUTORE NETO
Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2016	2017	2018	2019	2020				Millions of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Mjetet valutore neto	389,612.7	390,687.6	412,444.5	402,015.9	399,267.3	402,782.7	426,426.9	433,510.3	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	418,562.1	417,605.4	436,487.8	426,984.7	423,459.0	427,650.5	451,341.2	458,111.4	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	28,949.4	26,917.8	24,043.3	24,968.8	24,191.7	24,867.8	24,914.3	24,601.0	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	65,915.7	59,998	21,779	44,589	42,832	44,354	52,159	39,941	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	34,255.6	18,407	-12,366	8,490	14,820	15,118	18,155	4,692	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	53,279.9	52,839.5	55,628.9	55,206.3	55,414.6	55,998.2	57,463.1	61,787.7	Net Calims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	19,024.3	34,432.8	67,994.8	46,715.9	40,595.1	40,880.7	39,307.9	57,095.7	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	29,934.4	39,871.3	32,317.6	33,956.4	25,877.4	27,108.1	31,884.0	33,137.2	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,725.7	1,720.0	1,827.2	2,141.8	2,135.6	2,128.6	2,120.0	2,111.5	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	414,380.9	452,243.1	423,427.9	433,951.2	425,982.3	428,401.0	442,443.8	451,390.0	Monetary Baze
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	194.0	146.6	80.6	72.6	75.0	76.5	79.9	78.0	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	47.2	96.8	285.4	229.5	192.0	241.8	155.4	94.8	Other accounts payable
Të tjera neto	-20,953.6	-20,683	-20,659	-20,775	-21,185	-21,209	-21,203	-21,218	Other items net
Aksione	61,859.9	45,882.2	31,088.6	33,126.1	37,035.9	39,626.2	57,109.7	43,106.2	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 KREDIA PËR EKONOMINË
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020				Million of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Totali i kredisë	547,602.4	550,280.4	532,628.2	570,553.0	569,030.3	578,622.0	597,561.0	578,248.1	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale	845.5	787.7	539.0	560.6	548.4	541.6	529.9	517.3	Credits to local Government
Në lekë	845.5	787.7	539.0	560.6	548.4	541.6	529.9	517.3	in Lek
Në valutë	-	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	26,863.9	29,515.4	20,270.1	24,182.4	24,452.2	24,548.8	25,032.8	18,296.2	Credits to Public Non-financial Corporations
Në Lekë	23,993.9	24,453.5	16,594.2	18,489.7	18,911.4	19,016.3	19,046.1	13,205.2	in Lek
Në valutë	2,870.0	5,061.9	3,675.9	5,692.7	5,540.8	5,532.5	5,986.7	5,091.0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare private	343,483.0	334,762.9	317,722.0	335,884.6	333,540.0	341,303.0	355,039.6	346,928.10	Credits to other Non-financial Corporations
Në Lekë	131,743.5	136,075.7	127,999.7	141,240.5	138,603.2	142,452.2	142,922.9	144,815.80	in Lek
Në valutë	211,739.5	198,687.2	189,722.3	194,644.1	194,936.8	198,850.8	212,116.7	202,112.30	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	8,687.6	7,944.6	10,164.0	13,555.1	13,533	13,707	14,030	13,365	Credits to Other Financial Corporations
Në Lekë	4,242.3	3,522.3	4,802.1	8,023.8	7,837	7,878	7,890	7,654	in Lek
Në valutë	4,445.3	4,422.3	5,361.9	5,531.3	5,696.2	5,828.8	6,140.3	5,710.3	in Foreign Currency
Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë	167,722.4	177,269.8	183,933.1	196,370.3	196,956.5	198,521.8	202,928.5	199,141.9	Claims to other Resident Sectors
Në Lekë	98,722.3	108,419.1	118,744.1	130,170.0	130,778.4	131,415.3	131,311.4	131,198.6	in Lek
Në valutë	69,000.1	68,850.7	65,189.0	66,200.3	66,178.1	67,106.5	71,617.1	67,943.3	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 **OFERTA E PARASË**
Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020				Millions of LEK End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Baza monetare	414,380.9	425,243.1	423,427.9	433,951.2	425,982.3	428,401.0	442,443.8	451,390.0	Base Money
Ndryshimi vjetor në %	7.9	2.6	-0.4	1.0	1.0	1.0	1.0	1.1	Y/Y change in %
Paraja jashtë korporatave depozituese	249,256.5	265,156.0	275,281.4	291,409.0	286,606.8	289,080.3	293,718.4	303,148.9	Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor në %	4.2	6.4	3.8	5.9	5.5	6.0	6.9	11.0	Y/Y change in %
Depozita	737,808	741,157	745,304	791,041	801,527.9	805,289.8	823,023.0	808,060.6	Deposits
Ndryshimi vjetor në %	7.3	0.5	0.6	6.1	6.0	6.4	9.0	7.0	Y/Y change in %
Agregati M1	435,432.3	461,550.1	478,717.6	523,968.3	522,908.1	528,920.4	536,503.0	553,949.4	M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	13.4	6.0	3.7	9.5	8.7	9.3	10.1	14.1	Y/Y change in %
Agregati M2	736,944.1	738,900.0	731,352.3	758,021.7	756,567.1	762,539.4	767,868.1	785,434.6	M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	1.9	0.3	-1.0	3.6	3.3	4.0	4.3	7.3	Y/Y change in %
Agregati M3	1,263,453.8	1,266,906.9	1,263,928.1	1,318,662.0	1,324,332.3	1,330,924.1	1,365,566.1	1,345,011.4	M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	3.9	0.3	-0.2	4.3	3.9	4.1	6.8	5.8	Y/Y change in %
Burimet e bazës monetare									Monetary Base sources
Mjetet e huaja neto	389,612.7	390,687.6	412,444.5	402,015.9	399,267.3	402,782.7	426,426.9	433,510.3	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	65,915.7	59,998.0	21,779.0	44,588.6	42,832.4	44,354.3	52,159.2	39,940.7	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	34,255.6	18,406.7	-12,365.8	8,490.4	14,819.5	15,117.5	18,155.3	4,692.0	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	29,934.4	39,871.3	32,317.6	33,956.4	25,877.4	27,108.1	31,884.0	33,137.2	Claims on other depository corporatons

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020				Millions of Leks End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Në lekë	487,687	473,744	456,071	466,382	469,960	473,459	474,036	482,286	In national currency
Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë (D. p)	186,176	196,394	203,436	232,559	236,301	239,840	242,785	250,801	Transferable deposits+Liquid deposits
Qeveria lokale	1,907.5	1,344.4	1,482.1	1,624.5	1,472.6	1,569.4	1,564.3	1,615.8	Local governments
Korporata jofinanciare publike	6,786.0	8,656.7	8,861.1	10,786.4	11,223.7	11,877.3	12,055.6	12,487.1	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	2,071.0	2,524.8	2,586.8	3,780.6	3,766.8	4,176.9	4,355.6	3,958.5	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	46,051.0	48,979.3	49,221.4	51,972.3	53,900.1	53,152.6	52,950.5	53,160.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	129,360.4	134,889.0	141,284.9	164,395.5	165,938.1	169,064.0	171,858.6	179,579.3	Other resident sectors
Depozita të tjera	301,512	277,350	252,635	233,823	233,658	233,619	231,251	231,485	Other deposits
Qeveria lokale	18.9	15.2	13.1	10.1	10.1	10.1	10.1	10.1	Local governments
Korporata jofinanciare publike	976.8	705.2	1,634.7	709.2	627.9	1,484.2	1,484.7	3,234.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	7,553.4	9,282.1	5,050.5	4,146.7	3,922.6	3,909.4	4,044.5	3,916.0	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	6,502.2	9,062.4	9,687.0	7,977.5	8,705.0	8,821.5	8,056.0	7,379.6	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	286,460.2	258,285.1	236,249.4	220,979.3	220,392.8	219,393.8	217,655.6	216,945.2	Other resident sectors
Në valutë	250,121	267,413	289,233	324,659	331,568	331,831	348,988	325,775	In foreign currency
Qeveria lokale	366.1	139.8	113.4	157.9	107.4	132.4	50.4	66.8	Local governments
Korporata jofinanciare publike	2,999.4	2,086.3	1,407.7	2,823.3	2,785.9	2,773.8	3,613.9	2,735.4	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,815.4	3,756.9	3,616.6	5,360.3	5,662.3	4,932.1	5,201.8	4,034.8	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	73,325.0	74,187.3	78,055.3	81,786.9	83,945.3	84,592.0	86,698.6	79,151.5	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	171,614.8	187,242.7	206,039.8	234,530.3	239,067.3	239,400.3	253,422.8	239,786.3	Other resident sectors
Totali	737,808	741,157	745,304	791,041	801,528	805,290	823,023	808,061	Total
Qeveria lokale	2,292.5	1,499.4	1,608.6	1,792.5	1,590.1	1,711.9	1,624.8	1,692.7	Local governments
Korporata jofinanciare publike	10,762.2	11,448.2	11,903.5	14,318.9	14,637.5	16,135.3	17,154.2	18,456.7	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	11,439.8	15,563.8	11,253.9	13,287.6	13,351.7	13,018.4	13,601.9	11,909.3	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	125,878.2	132,229.0	136,963.7	141,736.7	146,550.4	146,566.1	147,705.1	139,691.1	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	587,435.4	580,416.8	583,574.1	619,905.1	625,398.2	627,858.1	642,937.0	636,310.8	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 13 BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH
Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020				Millions of Lek End of period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
AKTIVET	524,731	532,927	547,104	539,622	528,261	534,274	564,181	576,534	
Total	131,887	187,367	209,596	176,674	169,607	167,539	160,743	170,501	Total
Mbajtjet e SDR	27,211.8	25,725.3	19,625.0	24,187.9	25,173.3	24,919.7	26,350.7	47,437.3	SDR holdings
Arka në valutë	52.0	24.3	67.1	98.3	53.0	35.6	77.8	127.3	Foreign currency
Depozitat	104,622.9	161,617.3	189,904.2	152,387.6	144,381.0	142,583.6	134,314.1	122,936.1	Deposits
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	315,113	259,538	261,577	283,679	288,186	294,504	326,651	328,087	Securities other than shares
Jorezident	261,877.5	206,818.9	205,990.4	228,514.0	232,812.9	238,547.4	269,229.2	266,350.9	nonresidents
Qeveria qendrore	53,235.2	52,718.8	55,586.8	55,164.9	55,373.2	55,956.9	57,421.8	61,736.5	central government
Huatë	31,660	41,591	34,145	36,098	28,012	29,236	34,003	35,248	Loans
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	29,934.4	39,871.3	32,317.6	33,956.4	25,877.4	27,108.1	31,884.0	33,137.2	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,725.9	1,719.8	1,827.1	2,141.4	2,134.7	2,127.5	2,118.8	2,110.7	Other resident sectors
Derivatet financiare	15.8	11.7	19.3	13.8	25.3	31.9	34.8	24.2	Financial derivatives
Llogari të arketueshme	25,094.1	23,844.9	21,224.9	22,325.3	21,573.6	22,078.1	21,888.0	21,787.0	Receivable accounts
Mjetet jofinanciare	20,961.2	20,574.7	20,542.0	20,832.0	20,856.9	20,885.3	20,861.8	20,887.2	Nonfinancial assets
DETYRIMET	524,731	532,927	547,104	539,622	528,261	534,274	564,181	576,534	LIABILITIES
Total	262,031	278,611	286,209	303,195	297,287	299,611	306,310	313,040	Total
Para në qarkullim	258,848.0	274,711.8	286,158.4	303,092.6	297,238.9	299,550.9	306,263.2	312,981.4	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	3,183.2	3,899.2	50.6	102.2	48.4	59.6	46.3	58.3	Deposits included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	191,380	200,514	222,292	194,623	186,416	186,816	192,600	212,600	Deposits excluded from broad money
Jorezident	19,860.9	19,350.9	17,047.3	17,108.5	17,102.3	17,102.2	17,111.1	17,107.5	Nonresidents
Qeveria qendrore	18,975.1	34,384.3	67,945.2	46,685.3	40,543.6	40,846.6	39,274.2	57,063.7	Central government
Korporata të tjera depozituese	152,349.7	146,632.1	137,218.8	130,756.4	128,695.0	128,790.6	136,134.3	138,350.4	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	72.1	66.7	49.6	52.5	54.9	56.4	59.8	57.9	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	121.9	79.9	31.0	20.1	20.1	20.1	20.1	20.1	
Huatë	314	116	18	0	0	0	0	0	-
Jorezidentët	314.2	115.6	18.3	-	-	-	-	-	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
Llogari të pagueshme	1,164.6	463.8	518.7	1,690.8	432.6	1,131.5	596.2	589.3	Other accounts payable
Alokimi i SDR	7,981.2	7,340.5	6,977.7	6,987.3	7,089.4	7,090.1	7,566.1	7,199.6	SDR allocation
Aksione dhe instrumenta të tjerë	61,859.9	45,882.2	31,088.6	33,126.1	37,035.9	39,626.2	57,109.7	43,106.2	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania